FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.109 17 gusht 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.587, datë 7.7.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike	5405
Vendim i KM nr.589, datë 29.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.828, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave "Për shitjen e mjeteve dhe të teknikës luftarake të ushtrisë, të dala jashtë përdorimit, në formën e skrapeve", të ndryshuar	5406
Vendim i KM nr.590, datë 29.7.2010	Për dhënie ndihme financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë	5407
Vendim i KM nr.591, datë 23.7.2010	Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore	5408
Vendim i KM nr.592, datë 14.7.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë, miratuar për vitin 2010, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit, në Maqedoni, të shtetasit Sulejman Tafçiu	5409
Vendim i KM nr.594, datë 23.7.2010	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar, 2007, për financimin e projektit "Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale-faza 2"	5409
Vendim i KM nr.595, datë 23.7.2010	Për kalimin e pasurive të paluajtshme të "INSIG" sh.a., nga Ministria e Financave (INSIG), në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave	5411

Vendim i KM nr.596, datë 23.7.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Pukë të qarkut të Shkodrës	5414
Vendim i KM nr.597, datë 23.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.906, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për Shërbimin Kombëtar të Punësimit"	5415
Vendim i KM nr.598, datë 23.7.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga sistemim–asfaltimi i unazës së qytetit, në bashkinë e Fushë – Krujës ...	5417
Vendim i KM nr.599, datë 23.7.2010	Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike	5418
Vendim i KM nr.600, datë 23.7.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga hyrëse, Berat"	5425
Vendim i KM nr.601, datë 23.7.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit "Ish-kopshti nr.26", në Tiranë, me qëllim privatizimi	5428
Vendim i KM nr.602, datë 23.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", të ndryshuar	5429
Vendim i KM nr.603, datë 23.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar	5429
Vendim i KM nr.604, datë 23.7.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar	5430
Vendim i KM nr.605, datë 8.7.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.1093, datë 2.7.2008 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të sistemit tatimor", të ndryshuar	5430
Urdhër i MTKRS nr.434, datë 16.8.2010	Për rilicencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj "Albautor"	5432

VENDIM
Nr.587, datë 7.7.2010

PËR MONITORIMIN DHE KONTROLLIN E NIVELIT TË ZHURMAVE NË QENDRAT URBANE DHE TURISTIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet strukturave të tyre qendrore dhe rajonale, të marrin të gjitha masat për monitorimin e situatës në qendrat urbane e turistike në vend, duke ushtruar kontroll në të gjitha veprimtaritë e subjekteve fizike dhe juridike, të cilat janë burim zhurme.

2. Ministria e Shëndetësisë të angazhojë Institutin e Shëndetit Publik për kryerjen e matjeve dhe vlerësimin e nivelit të zhurmës, sipas udhëzimit të përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

3. Strukturat e njësive të qeverisjes vendore, në bazë të nenit 8 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të zbatojnë të gjitha kriteret ligjore në fuqi dhe masat e mbrojtjes nga zhurmat, duke aplikuar dhënien e lejeve për lokalet e ndryshme, sipas këtij përcaktimi:

3.1 Për mjediset e hapura orari i lejimit të veprimtarive, për ditët e premte dhe të shtunë, të jetë nga ora 19.00 deri në orën 24.00, ndërsa për ditët e tjera të javës të jetë nga ora 19.00 deri në orën 23.00, sipas normave të lejuara të zhurmës, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

3.2 Për mjediset e mbyllura, veprimtaria të lejohet pa kufizime orari, duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës të përcaktuar në udhëzimin e përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

4. Ministria e Brendshme, nëpërmjet strukturave të Policisë së Shtetit, të marrë të gjitha masat për mbështetjen e organeve e të strukturave shtetërore që ushtrojnë monitorimin e kontrollin e zhurmave në mjedis, si dhe të monitorojë zbatimin e orarit të përcaktuar në piken 3.1 të këtij vendimi.

5. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe strukturat ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore mbështesin Inspektoratin e Mjedisit, me kërkesën e tij, për zbatimin e vendimeve të marra nga ky Inspektorat ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Brendshëm përcaktojnë me udhëzim të përbashkët procedurat e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse në zbatimin e vendimeve të marra nga Inspektorati i Mjedisit.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë, brenda një afati 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe në zbatim të nenit 20 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të marrin të gjitha masat për hartimin e miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave.

7. Pas miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të miratojë programin dhe udhëzimet

përkatëse, të cilat u dërgohen organeve të qeverisjes vendore, që do të realizojnë, brenda vitit 2011, hartëzimin e zhurmës në nivel vendor, si dhe hartat strategjike të zhurmës, në nivel kombëtar.

8. Për bashkërendimin e punës dhe marrjen e masave për zbatimin me efikasitet të këtij vendimi, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, nëpërmjet strukturave të tyre qendrore dhe vendore, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe nën mbikëqyrjen e prefektit të qarkut, të ngrenë grupet përkatëse të punës, në nivel vendor.

9. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, prefektët e qarqeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.589, datë 29.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.828, DATË 30.12.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHITJEN E MJETEVE DHE TË TEKNIKËS LUFTARAKE TË USHTRISË, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT, NË FORMËN E SKRAPEVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.828, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave, bëhet ky ndryshim:

Në lidhjen A, në listën që i bashkëlidhet vendimit, numri rendor 2 "Nëndetësja 332 Tufani", numri rendor 10 "Katër silurues 302 Patrioti", numri rendor 11 "Katër silurues 303 Delfini", numri rendor 13 "Katër silurues 307 Luftëtari", numri rendor 15 "Katër silurues 309 Heroi", numri rendor 16 "Katër silurues 310 Trimi" dhe numri rendor 25 "Rimork detar 253 M.Ulqinaku", hiqen nga lista dhe i kalojnë, për qëllime muzeale, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.590, datë 29.7.2010

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE NJË KATEGORIE PERSONASH TË STREHUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010" dhe të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare prej 78 000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) lekësh në muaj, për pagesën e qirasë së banesës, të ushqimit, energjisë elektrike e të ujit, çdo shtetasi të huaj, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Pagesa të kryhet nga strukturat e Ministrisë së Brendshme, sipas udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.
3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, në shumën e përcaktuar, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

1. Abdu Rrauf Omar
2. Salih Bib Al'Hadi Essasi
3. Sherif Fat'hi Almeshad

Lidhja nr.2 Efektet financiare

Nr	Emër/mbiemër	Qira	Ndihmë financiare	Muaj	Total ndihmë financiare
1.	Abdu Rrauf Omar	35 000	43 000	12	936 000
2	Salih Bin Al'Hadi Essasi	35 000	43 000	12	936 000
3	Sherif Fat'hi Almeshad	35 000	43 000	12	936 000
Totali/lekë					**2 808 000**

Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur është parashikuar mbulimi i shpenzimeve të qirave të banesave për një periudhë 12-mujore. Kjo, pasi këta shtetas kanë firmosur kontrata qiraje banese njëvjeçare me agjencinë imobiliare dhe gjykojmë që këto kontrata të përsëriten për një periudhë njëvjeçare.

Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur ndihma financiare është përllogaritur për të mbuluar periudhën gusht 2010-gusht 2011.

VENDIM
Nr.591, datë 23.7.2010

PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet e personelit, të miratuara në ligjin nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, përbëjnë kufirin maksimal, të lejuar për t'u përdorur, për çdo njësi shpenzuese, për punonjësit e miratuar me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore. Për disiplinimin e këtyre shpenzimeve, vetëm për vitin 2010, të respektohen këto masa:

a) Shpenzimet e personelit, të dhëna me hollësi, në nivel mujor dhe të depozituara në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave, nuk avancohen.

b) Fondi i veçantë i planifikuar në shpenzimet e personelit të mos përdoret për shpërblime e për veprimtari social-kulturore, deri më datë 1 dhjetor 2010. Çdo shpërblim, i dhënë në kundërshtim me vendimin nr.1151, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave, përjashtuar pikën 5 të tij, të kthehet në buxhetin e njësisë shpenzuese.

c) Shpenzimet e personelit, për orë pune, mbi kohën normale të punës, të përdorura në kundërshtim me udhëzimin nr.19, datë 10.7.2008 të Ministrit të Financave "Për vendosjen e disa standardeve në planifikimin e shpenzimeve për personelin", të kthehen në buxhetin e njësisë shpenzuese.

ç) Të mos ndërmerren ndryshime në strukturat ekzistuese, që shoqërohen me efekte financiare shtesë. Përjashtohet nga ky kufizim krijimi i institucioneve të reja.

d) Pagesat për nëpunësit civilë, që janë në listë pritjeje, jepen vetëm pas konfirmimit zyrtar të Departamentit të Administratës Publike dhe përfshijnë pagesën për nivelin e pagës për funksion, pagës për diplomë dhe pagës për vjetërsi në punë.

dh) Të gjitha fondet buxhetore, që i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, të cilat deri më datë 1 gusht 2010 rezultojnë të paprokuruara, të bllokohen. Në kuptim të këtij vendimi, fonde të paprokuruara do të vlerësohen ato fonde, për të cilat, deri më 1 gusht, nuk është lidhur kontratë.

e) Trajnimet jashtë vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t'u mbuluar me fondet e miratuara për vitin 2010, bllokohen.

ë) Shpenzimet për udhëtime e dieta për njësitë e qeverisjes së përgjithshme të reduktohen, duke përfshirë vetëm udhëtime të rëndësisë së veçantë e vetëm për një numër të kufizuar punonjësish. Në çdo rast, për kryerjen e këtyre udhëtimeve, të merret miratimi i ministrit/titullarit të institucionit qendror.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

5408

VENDIM
Nr.592, datë 14.7.2010

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, MIRATUAR PËR VITIN 2010, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT, NË MAQEDONI, TË SHTETASIT SULEJMAN TAFÇIU

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri "Shpenzime operative", t'i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, në Maqedoni, të shtetasit Sulejman Tafçiu.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.594, datë 23.7.2010

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR, 2007, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË I ZONAVE RURALE-FAZA 2"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar, 2007, për financimin e projektit "Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale-faza 2", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR, 2007

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 16 tetor 2007,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditansalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e mëposhtme:

Një hua me vleftë prej deri në 1 500 000 euro (me fjalë një milion e pesëqind mijë eurosh) për projektin "Programi për furnizimin e zonave rurale me ujë", kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Nëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë bien dakord, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditansalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të lidhet midis Kreditansalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontrata përkatëse për hua nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2015.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditansalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratës, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditansalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huasë dhe nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë_____ , në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM
Nr.595, datë 23.7.2010

PËR KALIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË "INSIG" SHA, NGA MINISTRIA E FINANCAVE (INSIG), NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pasurive të paluajtshme, apartamente, lokale, mjedise shërbimi, në pronësi të "INSIG" sh.a., regjistruar në nr.hipotekor 7792, datë 13.10.1995, të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave.
2. Kalimin e truallit me nr.pasurie 9/15, zonë kadastrale 8330, me sipërfaqe 11416 m^2, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, si truall në bashkëpronësi të pandarë, në funksion të objekteve të pasqyruara në këtë planvendosje.
3. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të bëjë inventarizimin, me qëllim privatizimin në favor të familjeve që banojnë në këto godina, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr.19, datë 13.9.2007 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit "Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët".
4. Ngarkohet Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për regjistrimin e pasurive të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, sipas ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.
5. Procedurat e privatizimit dhe lidhja e kontratave të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e regjistrimit të këtyre pasurive në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, nga Enti Kombëtar i Banesave. Në rastet kur familja nuk pranon të lidhë kontratën, brenda

afatit të mësipërm, me Entin Kombëtar të Banesave, i humbet e drejta e privatizimit dhe pasuria përkatëse do të përdoret nga Enti Kombëtar i Banesave, në zbatim të programit të banesave me kosto të ulët.

6. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN VENDOSJE

SHKALLA 1:1000

INDEKSI I HARTES TR-KL-9,10 QYTETI TIRANE

ZONA KADASTRALE 8330 NUMRI I PASURISE 9/17,9/15,9/14

SIPERFAQE E TOTALE E TRUALLIT=11416 M2

NGA KJO:SIPERFAQJA NDERTIMORE 1-4269 M2

2-412 m2



VENDIM
Nr.596, datë 23.7.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË PUKË TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim bashkisë Pukë të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Pukë të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.364, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Pukë të qarkut të Shkodrës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Pukë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
5,7-14,17-21,28,34	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative. Pasuria nr.3, zona kadastrale 3069, me sipërfaqe 96 m^2 nuk transferohet (privat).	Në pronësi
38 -47	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
48-56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
57-64	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi
65-88	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
89	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
90-94	Varrezat publike.	Në pronësi

5414

95-101,111-144, 146-148,160	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
102-110,145	Infrastrukturë (Sheshe, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
149-158,165-166	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
159,406-419	Infrastrukturë (Rrugë vendore).	Në pronësi
171-174	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
392-395	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës -kanalizimeve.	Në pronësi
422-465	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi

VENDIM
Nr.597, datë 23.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.906, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA, PËR SHËRBIMIN KOMBËTAR TË PUNËSIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pikat 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.906, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, për masat e pronës të Zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Devoll, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUEJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror **Ministria e Punes Çeshtjeve Sociale dhe Shanceve te Barabarta**
Sherbimi Kombetar i Punesimit

Bashkia **Bilisht**

Fusha e perdorimit te prones **Zyra Vendore e Sherbimit Kombetar te Punesimit Bilisht**

Identifikoi: Eriona GAXHO, Pergjegjes Sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Brikena NALLBANI, Drejtor i Burim. Njerez. dhe Sherb.te Bl.endesh.
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Thoma MIÇO, Drejtor i Pergjithshem tel.2862236
(emri,mbiemri, pozicioni zyrtar, tel,firma,vula)

	A			B			C			
Nr rend	Zona Kadastrale dhe Indeksi i Hartes	Nr Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Siperfaqja Totale e Prones (m2)	Nga Sip.Totale sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative	Insitucioni/Enti perdorues. Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Administrative	Zyre Vendore e SHKP Devoll / Bilisht	55.2	55.2	Zyre Vendore Punesimi	M.P.Ç.S.SH.B	SH.K.P/ ZV SHKP Devoll (ne pronesi)	Ambientet ndodhen ne nje ndertese e cila eshte prone e Bashkise Bilisht. Jane gjithsej 3 zyra me siperfaqe 55.2 m2.

VENDIM
Nr.598, datë 23.7.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA SISTEMIM–ASFALTIMI I UNAZËS SË QYTETIT, NË BASHKINË E FUSHË - KRUJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga sistemim–asfaltimi i unazës së qytetit, në bashkinë e Fushë - Krujës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Fushë – Krujës.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) m², tokë arë, pronë private, me vlerë shpronësimi 72 160 (shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Fushë - Krujës.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Fushë - Krujës, planifikuar në buxhetin e saj.
6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Fushë - Krujës, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë, 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) m², tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Fushë - Krujës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Fushë - Krujës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR "SISTEMIM-ASFALTIMIN E UNAZËS SË QYTETIT", NË BASHKINË E FUSHË-KRUJËS

Nr.	**Emër, mbiemër**	**Sip.m² tokë bujqësore**	**Çmimi lekë/m²**	**Vlera lekë**	**Dokumenti i pronësisë**	**Zona kadastrale**
1	Petrit Ziri	160	451	72 160	Certifikatë pronësie	1665
	Totali	**160**		**72160**		

VENDIM
Nr.599, datë 23.7.2010

PËR MIRATIMIN E PAGESAVE QË KRYHEN NË AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE, TË NUMRAVE DHE TË SERIVE NUMERIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 3, e 119, pika 2 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesave, që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr.75, datë 6.2.2003 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e pagesave që kryhen pranë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve", i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

LLOGARITJA E PAGESAVE QË KRYHEN NË AKEP PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE, NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE

1. LLOJET E PAGESAVE QË KRYHEN NË AKEP

1.1 Pagesat që kryhen në AKEP janë pagesat për përcaktimin dhe përdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike dhe pagesat për certifikata, leje apo autorizime të tjera që lëshohen nga AKEP-ja, bazuar në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

1.2 Përjashtohen nga pagesat për caktimin edhe përdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike të gjithë përdoruesit në bazë të ligjit nr.9918; mund të përdorin frekuenca pa qenë nevoja të pajisen me autorizim individual.

1.3 Llogaritja e pagesave vjetore për caktimin edhe përdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike dhe pagesat e tjera që janë parashikuar në këtë vendim, llogariten në bazë të kësaj lidhjeje. Duke qenë se AKEP-ja nuk është entitet i regjistruar për efekt TVSH-je (tatimi mbi vlerën e shtuar), mbi këto tarifa nuk aplikohet TVSH-ja.

1.4 Llogaritja e pagesave për përdorimin e frekuencave, për periudhë jo të plotë të vitit, do të bëhet proporcional me numrin e muajve në përdorim. Pagesa më e vogël do të jetë ajo e një muaji.

1.5 Pagesat në AKEP sipas këtij vendimi, kryhen mbi bazën e faturës së lëshuar nga AKEP sipas formatit të përcaktuar në legjislacionin fiskal në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. PAGESAT PËR PËRDORIMIN E SPEKTRIT RADIO PËR SHËRBIMET E LËVIZSHME PUBLIKE TOKËSORE

2.1 Shërbimi telefonik publik i lëvizshëm tokësor

Pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave radio për shërbimin telefonik publik të lëvizshëm tokësor (GSM, UMTS 900/1800 MHz dhe UMTS (1900-1980) dhe (2010-2170) MHz, do të llogariten sipas të dhënave të tabelës nr.1.

Tabela nr. 1

Brezi i frekuencave MHz	**Njësia e matjes së brezit**	**Pagesa vjetore në lekë**
(880- 915)/(925-960)	Kanal (2x200) kHz	100 000
1710-1785 /1805-1880	Kanal (2x200) kHz	100 000
(1920-1980) / (2110-2170)	Brez (2x5) MHz	2 000 000
(1900-1920) MHz dhe (2020-2025) MHz	Brez (1 x5) MHz	1 000 000

2.2 Shërbimi privat i lëvizshëm radio — PMR

a) Pagesa për çdo sistem radio PMR, TETRA dhe Paging të reflektojë gjerësinë e spektrit që i caktohet sipërmarrësit për përdorim, d.m.th merr parasysh numrin e kanaleve të frekuencave, zonën gjeografike mbi të cilin sistemi radio operon, sasinë e pajisjeve radio që përbëjnë sistemin d.m.th stacion bazë, përsëritës, pajisje radio të montuar në makinë dhe pajisjet radio të dorës.

b) Kanali i frekuencave radio për sistemet PMR-ka gjerësinë B = 12.5 kHz. Pagesat vjetore të mësipërme i përkasin sistemeve dupleks të radio komunikimit, 2x12.5 kHz. Në rastin e sistemeve simpleks PMR, pagesa do të llogaritet me gjysmën e vlerës/vlerave të tabelës së mësipërme.

Tabela nr.2

Kategoria	**Përshkrimi**	**Zona e ofrimit të shërbimit**		**Pagesa për çdo vit, për çdo sistem në lekë**	
1	Sistem PMR lokal (*On-site*).	Me rreze ≤3 km		10 000 lekë/kanal	
2	Stacion radio-bregdetar/ stacion tokësor aeronatik.	Në qytetet bregdetare dhe aeroportet		10 000 lekë/kanal	
3	Sistem PMR në zonë lokale	Zonë e shërbimit me rreze deri:		Pagesat për zonën me rreze deri në:	
				15 km	30 km
3.a	Numri i përgjithshëm i pajisjeve radio të sistemit PMR deri, baras 10 copë.	≤ l5 km	≤ 30 km	15 000	25 000
3.b	Numri i përgjithshëm i pajisjeve radio të sistemit PMR deri 20 copë.			25 000	35 000
3.c	Numri i përgjithshëm i pajisjeve radio të sistemit PMR mbi 20 copë.			30 000	40 000
4	Sistem PMR në zonë të gjerë shërbimi	Zonë gjeografike me rreze deri:		Pagesa për çdo vit, për çdo sistem	
4.a	Numri i përgjithshëm i pajisjeve radio të sistemit PMR deri, baras 10 copë.	≤ 50 km		50 000	
4.b	Numri i përgjithshëm i pajisjeve radio të sistemit PMR deri 20 copë.			60 000	
4.c	Numri i përgjithshëm i pajisjeve radio të sistemit PMR mbi 20 copë.			70 000	
5	Sistem PMR në zonë shërbimi kombëtar	**> 50 km**		**100 000**	

2.3 Shërbimi fiks radio

1. Lidhje fikse radio përcaktohet lidhja midis dy stacioneve fikse radio, të vendosura në pika të caktuara saktë gjeografikisht.

2. Pagesa vjetore për një lidhje radio, e cila në një drejtim të caktuar, përdoret me të dy polarizimet horizontal (H) dhe vertikale (V), do të jetë e njëjtë, si dhe në rastin kur përdoret me një polarizim.

3. Pagesat për lidhjet radio pikë shumë pika —PMP, do të llogaritet me 4-fishin e shumës së pagesës së një lidhjeje fikse radio pikë-pikë, P-P.

4. Pagesa vjetore për lidhjet fikse radio njëdrejtimëshe pikë-pikë (P-P) do të jenë sa gjysma e pagesave të dhëna në tabelën e mëposhtme tabela nr. 2.

5. Llogaritja e pagesave, për lidhjen fikse radio të modifikuar apo të ndryshuar, për përdorim deri në përfundim të vitit kalendarik do të bëhet proporcionalisht me afatin e vlefshmërisë së përdorimit, për muaj, bazuar në pagesën vjetore. Vlera e pagesës vjetore të këtyre lidhjeve fikse radio, të modifikuar apo të ndryshuar, do të krahasohet me atë që është kryer në fillim të vitit, për lidhjet ekzistuese. Kur vlera e pagesës së lidhjes radio të modifikuar apo të ndryshuar, është më madhe se ajo e fillimit të vitit, subjekti duhet të paguajë diferencën. Kur vlera e pagesës së lidhjeve radio të modifikuar apo të ndryshuar, është më vogël se ajo e fillimit të vitit, subjekti nuk do të rimbursohet për diferencën.

6. Gjerësia e kanalit radio për lidhjet fikse radio në brezin e frekuencave:

Deri në 30 MHz (≤ 30MHz) është 10 kHz ; dhe

Mbi 30 MHz (>30 MHz) është 25 kHz.

7.Pagesa vjetore për lidhjet fikse radio janë sipas tabelës nr. 3

Tabela nr.3

Brezi i frekuencave	**Gjerësi kanali (BW)**			
	BW≤3.5MHz	3.5<BW≤2OMHz	20<W≤40MHz	BW>4OMHz
f≤ 1 GHz	50 000	--	--	--
1GHz < F ≤ 14 GHz	60 000	78 000	90 000	120 000
14 GHz < F≤ 20 GHz	55 000	70 000	80 000	100 000
20 GHz < F≤37 GHz	45 000	60 000	70 000	80 000
37 GHz < F≤ 39.5 GHz	35 000	45 000	55 000	65 000
F> 39.5 GHz	10 000	13 000	15 000	20 000

2.4 Shërbimi radio FWA/BWA

1. Pagesat vjetore për përdorimin e brezave të frekuencave (3.41- 3.5)/(3.6-3.80 GHz, (10,15-10,3)/(10.5-10.65) GHz, (24.5— 26.5) dhe (27.5-29.5) GHz do të jenë:

a) Përdorim në zonë lokale/rajonale:

Tabela nr.4

Gjerësia e brezit MHz	**Pagesa vjetore në lekë**
B ≤ 7 MHz	200 000
7MHz <B ≤14 MHz	400 000
14 MHz <B ≤ 28 MHz	600 000

b) Përdorim kombëtar:

Tabela nr.5

Brezi i frekuencave (GHz)	Pagesa në lekë për çdo 1 MHz gjerësi brezi
3.41 —3.8	80 000 lekë
10.1 — 10.7	60 000 lekë
24.5—26.5 dhe 27.5-29.5	50 000 lekë

2. Llogaritja e gjerësisë së brezit do të bëhet duke marrë në konsideratë të dy pjesët e brezit në rastin FDD, d.m.th për brez 2x5 MHz, në dispozicion të sipërmarrësit, llogaritja e pagesës do të bëhet me brez me gjerësi 10 MHz.

2.5 Shërbimet satelitore

1. Pagesa vjetore për përdorimin e frekuencave, kur sistemi satelitor ka vetëm një stacion satelitor tokësor fiks, fuqia EIRP, e të cilit është më e madhe se 50 dBW (EIRP > 50 dBW) dhe frekuenca e punës është në një apo te dy brezat e frekuencës së përdorimit ekskluziv, përcaktohet nga tabela nr.5.

Tabela nr.6

Brezi i frekuencave	Fuqia EIRP (dBW)	Numri i pajisjeve	Pagesa vjetore (në lekë)
(12,5-12,75)GHz ose (14,0-14,25) GHz	< 50		Nuk aplikohet pagesë
	≥ 50	Deri në10 SES	20 000
		Për çdo SES shtesë mbi numrin 10	Do të shtohet pagesa 3 000 lekë

2. Pagesa vjetore, kur stacioni satelitor tokësor fiks, i vetëm në sistem, përdor një frekuencë pune të ndryshme nga ato të brezave të frekuencave të dhëna më lart në pikën 1, pra frekuenca të brezave joekskluzive, dhe kjo frekuencë është në brezat e frekuencës më të madhe se 3GHz (f > 3 GHz), dhe ky stacion satelitor tokësor fiks operon vetëm me një stacion hapësinor, është në vartësi të gjerësisë së spektrit të përdorur, fuqia EIRP së transmetimit, brezit të frekuencave dhe llogaritet sipas tabela nr.7.

Pagesa vjetore (lekë) Tabela nr.7

Brezi i frekuencës (GHz)	Gjerësia e brezit (MHz)	EIRP < 50 dBW	50 dBW≤ EIRP ≤ 75dBW	EIRP > 75dBW
3-10	BW < 0.5	100 000	125 000	150 000
	0.5 ≤ BW < 2	125 000	150 000	175 000
	2 ≤ BW < 11	150 000	175 000	200 000
	11≤ BW < 40	175 000	200 000	225 000
	40 ≤ BW ≤ 80	200 000	225 000	250 000
	BW > 80	200 000+ (BW-80) x 3 000	225 000+ (BW — 80) x 3 000	250 000 +(BW – 80) x 3 000

10-15	BW <0.5	50 000	75 000	100 000
	0.5≤BW <2	75 000	100 000	125 000
	2≤BW<11	100 000	125 000	150 000
	11≤BW <40	125 000	150 000	175 000
	40≤BW<80	150 000	175 000	200 000
	BW> 80	150 000+ (BW — 80) x 3 000	175 000+ (BW — 80) x 3 000	200 000+ (BW — 80) x 3 000
15-20	BW <0.5	35 000	60 000	85 000
	0.5 ≤ BW <2	60 000	85 000	110 000
	2≤BW <11	85 000	110 000	135 000
	11 ≤BW<40	110 000	135 000	160 000
	40≤ BW<80	135 000	160 000	185 000
	BW>80	135 000+ (BW - 80) x 3 000	160 000+ (BW - 80) x 3 000	185 000+ (BW - 80) x 3 000
20-30	BW <0.5	25 000	50 000	75 000
	0.5 ≤ BW<2	50 000	75 000	100 000
	2≤BW <11	75 000	100 000	125 000
	11 ≤ BW<40	100 000	125 000	150 000
	40 ≤ BW <80	125 000	150 000	175 000
	BW > 80	125 000+ (BW- 80) x 3 000	150 000+ (BW-80) x 3 000	175 000+ (BW - 80) x 3 000
>30	BW<0.5	10 000	35 000	60 000
	0.5 ≤ BW<2	35 000	60 000	85 000
	2 ≤ BW<11	60 000	85 000	110 000
	11≤ BW<40	85 000	110 000	135 000
	40 ≤ BW<80	110 000	135 000	160 000
	BW >80	110 000+ (BW- 80) x3 000	135 000+ (BW-80) x 3 000	160 000+ (BW-80) x 3 000

3. Pagesa vjetore për përdorimin e frekuencave, për sistem stacionesh satelitore (teleport) i përbërë nga dy ose më shumë stacione tokësore satelitore fikse (jo të transportueshme), të vendosura në vende të caktuara, të aftë për të transmetuar në të njëjtën kohë, në më shumë se një frekuencë, me më shumë se një stacion satelitor të hapësirës, të cilët bashkërisht sigurojnë, komunikimet elektronike brenda rrjetit, bëhet në bazë të shumës së gjerësive të spektrit të frekuencës, që përdor çdo stacion tokësor satelitor në përbërje të sistemit (teleportës) dhe zbatohen vlerat e tabelës nr.7.

Tabela nr.8

Gjerësi e brezit BW	**Pagesa për 1 vit (12 muaj) në lekë**
BW ≤ 500 kHz	600 000
500 kHz < BW ≤2 MHz	700 000
2 MHz<BW≤ 11 MHz	900 000
11 MHz < BW ≤40 MHz	1 000 000
40 MHz < BW ≤ 80 MHz	1 500 000
BW>80 MHz, për çdo 1 MHz, gjerësi spektri ose pjesë të 1 MHz.	1 500 000 + (BW — 80) x 15 000

a) Për çdo shtesë në numrin e stacioneve satelitore tokësore fikse, pagesa vjetore do të shtohet me 150 000 lekë.

b) Për çdo shtesë në numrin e stacioneve satelitore hapësinore, për të siguruar komunikimin me një apo më shumë stacione satelitore tokësore fikse të sistemit, pagesa vjetore do të shtohet me 150 000 lekë.

2.6 Pagesa për shërbime të tjera radio, leje dhe autorizime.

Tabela nr.9

Nr	Emërtimi		Pagesa vjetore (në lekë)
1.Shërbimin aeronautik, detar, radio përcaktimit, radio navigacionit			
1.1	Sistem radio komunikimi aeronautik në tokë, pavarësisht numrit të stacioneve bazë, të stacioneve të lëvizshme dhe portative		15 000
1.2	Sistem radio në avion me aftësi ngritëse deri 2750 kg		10 000
1.3	Sistem radio në avion me aftësi ngritëse mbi 2750 kg		15 000
1.4	Sistem radio për navigim, identifikim, përcaktim pozicioni, sinjalizim etj.		3 000
1.5	Sistem radio komunikimi në anije		7 500
1.6	Shenjë thirrje anije		2 500
1.7	Kodi MMSI		2 500
1.8	Kodi AAIC (Kodi identifik autoritetit të llogarisë)		3 000
2.	Shërbimi radioamator dhe operator radiodetar		
2.1	Certifikatë radioamatori		500
2.2	Stacion radioamator – leje transmetimi dhe shenjë thirrje aplikim individual		500
2.3	Stacion radioamator – leje transmetimi dhe shenjë thirrje aplikim i shoqërisë/klubit radioamator		500
2.4	Stacion radio amator – leje transmetimi radioamatori të huaj		
2.5	Stacion radio amator – leje transmetimi radioamatori të huaj	1 -mujore	500
		3 -mujore	1 000
		6 -mujore	2 000
2.6	Certifikatë operator radio detar	çdo 3 vjet	3 000
3. Për kërkim dhe eksperimentimi pajisjesh			
3.1	Stacion, stacione radio me qëllim kërkimi matjeje dhe testimi e eksperimentimi të pajisjeve		Pagesa për 3 muaj, proporcionale me pagesën vjetore, të llogaritur sipas tabelës së shërbimit përkatës radio
4.	Miratim tipi pajisjesh		
4.1	Certifikatë konformiteti pajisjesh për subjektet tregtare vendase		3 000,00 vetëm një herë
4.2	Certifikatë konformiteti pajisjesh për subjektet jotregtare vendase		1 000,00 vetëm një herë
4.3	Certifikatë konformiteti pajisjesh për subjektet e huaja		100 euro vetëm një herë

3. Pagesa për përcaktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike
(Propozimi përfundimtar pas vërejtjeve të operatorëve)

Tabela nr.10 (në lekë)

Nr	Emërtesa	Pagesa për caktimin e numrave dhe serive numerike	Pagesa vjetore për përdorim të numrave dhe serive numerike
1	Numra gjeografikë: -Bllok 1 000 numrash -Bllok 10 000 numrash	 1 000 1 000	 1 000 4 000
2	Numra jogjeografikë për: Shërbimin e komunikimeve publike të lëvizshme Shërbimin Paging (63) Shërbimin e komunikimeve personale (700) -Bllok 1 000 numrash -Bllok 10 000 numrash	 1 000 1 000	 2 000 5 000
3	Numra jogjeografikë për: Shërbimin Free-Phone (800) –numër jeshil Shërbimin me ndarje të kostos (808)-numër blu	1 000	25 000
4	Numra jogjeografikë për: Shërbimi data, network, internet (717) Rrjeta për qëllime specifike (711) Shërbimi posta zanore (712) Rrjeta virtuale private (713)	1 000	25 000
5	Numra jogjeografikë për: Shërbimin me ndarje të ardhurash (900) Shërbimin e kartës së parapaguar (801)	1 000	25 000
6	Kodi i shkurtër për shërbimin SMS/MMS me vlerë të shtuar (VAS), formati 5XXXX (ku X=0÷9): -numër individual -bllok 10 numrash	 1 000 2 000	 20 000 100 000
7	Kodi i shkurtër i harmonizuar në nivel europian (HESC), Formati :11 X dhe 19X (ku X=0÷9)	1 000	Pa pagesë
8	Kodi i shkurtër i urgjencës, Formati 12X ((ku X=5÷9)	1 000	Pa pagesë
9	Kodi i aksesit për bartësin, Formati 10XX ((ku X=0÷9)	2 000	40 000
10	Kodi i rrugëzimit për portabilitetin e numrit, Formati 99XX ((ku X=0÷9)	1 000	20 000
11	Kodi i pikës kombëtare të sinjalizimit - NSPC	1 000	20 000
12	Kodi i pikës ndërkombëtare të sinjalizimit - ISPC	2 000	50 000
13	Kodi i rrjetit mobile –MCC/MNC	2 000	50 000
14	Kodi i identifikimi të rrjetit, transmetimit të dhënash DNIC	2 000	50 000

Shënim: Pagesa për rastet e rezervimit të numeracionit dhe kërkesës për numeracion për aplikime eksperimentale ose të përkohshme është 50% e vlerës së parashikuar në tabelën më sipër.

VENDIM
Nr.600, datë 23.7.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA HYRËSE, BERAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit, për vitin 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga hyrëse, Berat".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 236 (një mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m^2, tokë truall, të vlerësuar me çmimin 3100 (tre mijë e njëqind) lekë/m^2, me vlerë 3 831 600 (tre milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë, si dhe për objekt, me vlerë 318 883 (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 4 150 483 (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 655 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 4 150 483 (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre) lekë, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve.
6. Shpronësimi të fillojë më 30.7.2010 dhe të përfundojë më 30.10.2010.
7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Pronari, për të cilin në kolonën "Shënime" është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja "Objekti në proces legalizimi", të kompensohet për vlerën e objektit, pasi të kenë përfunduar procedurat përkatëse të legalizimit e të regjistrimit, si dhe pasi të ketë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve do të kryejë likuidimin e pronarit, për të cilin është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja, "Objekti në proces legalizimi" pasi të kenë përfunduar procedurat përkatëse të legalizimit e të regjistrimit, si dhe pasi ky pronar të ketë paraqitur dokumentacionin e pronësisë.
11. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Berat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

12. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Berat, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Berat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE BERAT

Nr	Pronari			ZK	Nr.Pas	Tokë truall			Objekt Vlera lekë	Vlera Totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.	Çmimi	Vlera			
1	Shefit		Kasapi	8501	2/99	180	3100	558000		558000	Konfirmuar nga ZRPP
2	Jemin		Toto	8501	2/120	74	3100	229400		229400	Konfirmuar nga ZRPP
3	Jemin		Toto	8501	2/12 1	32	3100	99200		99200	Konfirmuar nga ZRPP
4	Sulejman		Toto	8501	2/123	40	3100	124000		124000	Konfirmuar nga ZRPP
5	Xhevair	Isuf	Gega	8501	2/128	*155*	3100	480500		480500	Konfirmuar nga ZRPP
6	Safet		Tomorri	8501	2/142	235	3100	728500	318883	1047383	Konfirmuar nga ZRPP; Objekti në "Proces Legalizimi"
7	Vasil		Papa	8501	6/74	17	3100	52700		52700	Konfirmuar nga ZRPP
8	Vasil		Papa	8501	6/75	14	3100	43400		43400	Konfirmuar nga ZRPP
9	Sadush		Skrevani	8501	6/73	133	3100	412300		412300	Konfirmuar nga ZRPP
10	Blerim		Daji	8501	6/86	62	3100	192200		192200	Konfirmuar nga ZRPP
11	Resul		(Eskiu) Gusho	8501	6/85	200	3100	620000		620000	Konfirmuar nga ZRPP
12	Dashnor		Xhamari	8501	6/78	20	3100	62000		62000	Konfirmuar nga ZRPP
13	Lutfi		Kabilo	8501	6/20	37	3100	114700		114700	Konfirmuar nga ZRPP
14	Fatmir		Hoxha	8501	7/234	29	3100	89900		89900	Konfirmuar nga ZRPP
15	Besnik		Bardhi	8501	3/90	5	3100	15500		15500	Konfirmuar nga ZRPP
16	Kujtim		Jaho	8501	3/92	3	3100	9300		9300	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali				**1236**		**3831600**	**318883**	**4150483**	Konfirmuar nga ZRPP

VENDIM
Nr.601, datë 23.7.2010

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTIT "ISH-KOPSHTI NR.26", NË TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale, për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, të pronës së paluajtshme shtetërore, objektit "ish-kopshti nr.26", në rrugën "Kostaq Cipo", Tiranë, me numër pasurie 5/131, numër kadastral 8180, P-7, me numër rendor 346, në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës".

2. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të lidhë kontratat e privatizimit me banorët, të përfshirë në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara me udhëzim të veçantë të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Enti Kombëtar i Banesave të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

Nr.	Emër, mbiemër
1	Dylber Sadik Vasha
2	Tomor Sadik Vasha
3	Artur Estref Myrteza
4	Fatbardha Izet Myrteza
5	Elida Hysen Burimi
6	Ramadan Hysen Metko
7	Pembe Ali Ceku
8	Bardhyl Bektash Vasha
9	Napolon Ferid Myrteza
10	Ferit Avdyl Myrteza

VENDIM
Nr.602, datë 23.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.7.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fjalinë e parë të pikës 4 të vendimit nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "… çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi …" zëvendësohen me "… me indeksin e çmimeve të konsumit …".

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.603, datë 23.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikat 8 e 13 të vendimit nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "… çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi …" zëvendësohen me "… me indeksin e çmimeve të konsumit …".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.604, datë 23.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fjalinë e parë të pikës 4 të vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "… çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi …" zëvendësohen me "… me indeksin e çmimeve të konsumit …".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.605, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1093, DATË 2.7.2008 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1093, datë 2.7.2008, të ndryshuar bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tatimeve", bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave për vitin 2010.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

				PAGA MUJORE			
			EMËRTIMI	**PAGA INDIVIDUALE**		**SHTESA E POZICIONIT**	
Kategoria e vendit të punës	**Kategoria e pagës**	**Paga e grupit (PG)**		**Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për kualifikim (SHK)**	**Shtesa e pozicionit (SHP)**	**Shtesa për kushte pune**
1	2	3	4	5	6	7	8
	II-a	1	Drejtor i Përgjithshëm	2%		105 000	20 000
	II-b	1	Zv/drejtor i përgjithshëm	2%		88 000	15 000
A	III-a	1	Drejtor drejtorie në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor i drejtorisë rajonale.	2%		71 000	15 000
B	III-a/1	1	Përgjegjës/shef sektori në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale.	2%		62 000	14 000
C.1	III-b	1 ose 2	Përgjegjës/shef sektori/zyre në drejtoritë rajonale. Inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtoritë mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.	2%		54 000	12 000
	III-b	1 ose 2	Përgjegjës zyre në Task-Forcë	2%		54 000	17 000
C.2	IV-a	1 ose 2 ose 3	Inspektor i dytë. Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme. Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në drejtoritë rajonale.	2%		43 000	12 000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme.Inspektor hetimi/Specialist në drejtoritë rajonale.	2%		33 000	10 000
C.3	IV-c	1 ose 2 ose 3	Specialist	2%		25 000	5000
D.1	IV-b	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtorinë e përgjithshme	2%		33 000	5000
	IV-c	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtoritë rajonale.	2%		25 000	5000
			Nëninspektor	1%		28 000	10 000

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

URDHËR
Nr.434, datë 16.8.2010

PËR RILICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË SË DREJTËS SË AUTORIT NË FUSHËN E MUZIKËS DHE REGJISTRIMEVE MEKANIKE TË SAJ "ALBAUTOR"

Duke marrë parasysh propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit nr.615, Prot., datë 28.7.2010 për rilicencimin e Agjencisë "ALBAUTOR" për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autorëve në fushën e muzikës dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike,

KONSTATOVA:

Se, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", i ndryshuar, është kompetencë e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miratimi i ridhënies së licencës kësaj Agjencie në fushën e muzikës dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 108, pika 1 dhe 109, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhur me të",

URDHËROJ:

1. Rilicencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit "ALBAUTOR" në fushën e muzikës dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike.

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Ferdinand Xhaferaj

5432

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT
MINISTRI

LIÇENCË

Nr 1 Dt 16/08/2010

Në mbështetje të ligjit Nr. 9380, dt 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të" dhe V.K.M Nr. 232, datë 19.04.2006, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, mbasi konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga Agjensia "Albautor", është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për të drejtat e autorit dhe të tjera të lidhura me të,

VENDOSI:

Të riliçencojë subjektin "ALBAUTOR"
si Agjenci e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorit për degën e artit:
"Muzika dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronesisë artistike "
Njohur si person juridik me Vendimet e të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.587/1 datë 15.07.2005 dhe Nr. 587/3, datë 30.03.2010
Person i tatueshëm me Nr. NIPT: J81512003D,
Selia: Rr. "Andon Zako Çajupi", Nd. 18, H.5. Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë, Shqipëri.
Drejtor Ekzekutiv: Z.Idar BISTRI

Liçenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare
Kjo liçencë hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

Liçenca duhet të ekspozohet në zyrat e agjensisë

MINISTRI
FERDINAND XHAFERAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TIRANË

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 16.8.2010
Doli nga shtypi më 17.8.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë